



PLANI I BARAZISË GJINORE

2026-2028

BASHKIA KOLONJË

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike	3
Analiza e situatës gjinore në territorin e bashkisë	5
Demografia	6
Analfabetizmi.....	7
Niveli Arsimor	8
Statusi martesor.....	10
Statusi i nënës	12
Frekuentimi i Çerdhes.....	14
Frekuentimi i Kopshtit	16
Persona me Aftësi të Kufizuar	17
Punëkërkesit e papunë sipas njësive administrative	19
Metodologjia	23
Vizioni dhe objektivat strategjike	25
Qëllimet dhe objektivat strategjike	26
Qëllimi Strategjik 1 (Q1):	26
Qëllimi Strategjik 2 (Q2):	27
Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	28
Qëllimi strategjik 1:	28
Qëllimi strategjik 2:	34
Monitorimi dhe Raportimi	42

Parathënie

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave ka qenë gjithmonë prioritet për Bashkinë Kolonjë. Në përpjekje për t'i çuar këto angazhime në një nivel më të thelluar, në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar, kemi ndërmarrë hapa konkretë për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet tona vendore. Me kënaqësi ju prezantojmë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Ky plan strategjik është ndërtuar përmes një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës, që ka përfshirë aktivisht drejtues dhe specialistë të bashkisë dhe njësive administrative, përfaqësues të komunitetit, institucione arsimore dhe shëndetësore, organizata të shoqërisë civile, si dhe ekspertë të Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, me mbështetjen teknike të Smart Processes.

Plani Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028 është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të nevojave lokale, duke reflektuar përvojën e akumuluar nga zbatimi i politikave të mëparshme në fushën e barazisë gjinore. Ky dokument merr parasysh praktikën më të mira, si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, me synimin për të ndërtuar një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në promovimin e barazisë gjinore në nivel vendor.

Në Planin përmban masa të qarta dhe të strukturuar për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në procese vendimmarrëse, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, si dhe për adresimin efektiv të dhunës me bazë gjinore në komunitet. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cenuara të shoqërisë, përfshirë gratë që jetojnë në zona rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara dhe ato që kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës.

Bashkia Kolonjë mbetet e angazhuar fuqishëm për ndërtimin e një shoqërie të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, ku të drejtat e çdo individi respektohen dhe garantohen pa përjashtim. Besojmë se arritja e këtij vizioni kërkon një përpjekje të përbashkët dhe një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit dhe qytetarëve.

Prandaj, ftojme të gjithë aktorët—pa dallim statusi apo fushe veprimi—të bëhen pjesë aktive në zbatimin dhe mbështetjen e këtij plani. Vetëm përmes angazhimit të përbashkët mund të garantojmë një të ardhme më të barabartë dhe më të drejtë për të gjitha gratë dhe vajzat e komunitetit tonë.

Angazhimi ynë, drejt një Bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!

Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike

Në nivel lokal, kuadri ligjor dhe institucional që udhëheq përpjekjet për barazinë gjinore në Bashki ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18/2, garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”: Ky ligj përcakton parimet themelore të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe promovon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës publike. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për mbledhjen e statistikave gjinore dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e politikave gjinore në nivel vendor.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: Ky ligj i njeh bashkive një rol kyç në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore. Neni 6 i këtij ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Neni 62 u kërkon bashkive të respektojnë parimin e barazisë gjinore në emërimet në pozita drejtuese si nënkryetarë bashkie dhe administratorë njësisish.

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”: Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor vendor. Ai kërkon që ndarja dhe përdorimi i fondeve të buxhetit të orientohen drejt garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra, si dhe ofron fleksibilitet për të financuar politika që adresojnë nevojat gjinore.

Ligji nr. 57/2016 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një nga parimet e sistemit buxhetor. Kjo mbështet integrimin gjinor në planifikimin dhe menaxhimin financiar vendor.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili përcakton detyrimet e bashkive për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

Ligji nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor dhe e obligon pushtetin vendor të marrë masa për promovimin e barazisë.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, i cili përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të marginalizuara në nivel lokal.

Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”, i cili krijon mundësi për punësimin e grave në situata të pafavorshme përmes nxitjes së iniciativave lokale.

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, që sanksionon parimin e barazisë gjinore dhe garanton përfshirjen e vajzave të reja në jetën politike dhe sociale të bashkisë.

Kodi i Punës, me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2020, që detyron institucionet publike vendore të sigurojnë mjedis pune pa ngacmime dhe diskriminim për shkak të gjinisë. Ligji nr. 104/2014 për sigurimet shoqërore, që përfshin të drejtën e lejes prindërore për burrat dhe nënat që rikthehen në punë.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që siguron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të marginalizuara.

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, që përcakton mbështetje për gratë viktimat të dhunës në familje dhe trafikimit përmes banesave sociale.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021, shërben si dokumenti udhëzues kryesor për këtë plan. Ajo orienton objektivat dhe masat strategjike për promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë (si CEDAË, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit, Objektivin e Zhvillit të qëndrueshëm 5, etj.).

Bashkia , nëpërmjet këtij Plani, harmonizon politikat vendore me këtë dokument kombëtar dhe merr përgjegjësi për zbatimin e tij në nivel lokal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik siguron themelin mbi të cilin Bashkia ndërton dhe zbaton politika të integruara për barazi gjinore, përfshirje dhe drejtësi sociale.

Plani është i harmonizuar me:

- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030
- Planin e zhvillimit 2026–2028 të Bashkisë Kolonjë
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 dhe 10
- Programin Kombëtar të Integritimit Evropian

Analiza e situatës gjinore në territorin e bashkisë

Bashkia Kolonjë ndodhet në juglindje të Shqipërisë dhe karakterizohet nga një terren kryesisht malor dhe natyrë e pasur. Zona ka një trashëgimi të fortë historike dhe kulturore, me tradita të thella dhe komunitete të ngrohta mikpritëse.

Bashkia Kolonjë është e njohur për peizazhet e saj natyrore, mundësitë për turizëm malor dhe bujqësinë tradicionale. Ajo fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësimin e jetës së banorëve duke ruajtur ambientin dhe kulturën lokale.

Bashkia Kolonjë përfshin 8 njësi administrative:

Njesia Administrative	Tipologjia
Ersekë	rural
Qendër Ersekë	rural
Qendër Leskovik	rural
Novoselë	rural
Barmash	rural
Mollas	rural
Çlirim	rural
Leskovik	rural

Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth 7,519 **banorë**, me një shpërndarje të popullsisë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Në aspektin social, bashkia është përballur me sfida që lidhen me migrimin e të rinjve, papunësinë, dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve sociale, në veçanti për grupet më vulnerabël si gratë, të moshuarit, dhe personat me aftësi ndryshe.

Bashkia Kolonjë është e angazhuar në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke promovuar vlera si transparenca, barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, hartimi i **Planit të Barazisë Gjinore** përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

Demografia

Tabela më poshtë paraqet popullsinë e bashkisë sipas gjinisë:

Popullsia	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Popullsia	3809	3710	7519	50.7	49.3


Burimi: INSTAT

Popullsia është e ndarë nëpër njësi administrative si më poshtë:

#	Njesia Administrative	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ersekë	1394	1428	2822	49.4	50.6
2	Qendër Ersekë	1009	932	1941	52.0	48.0
3	Qendër Leskovik	97	76	173	56.1	43.9
4	Novoselë	111	87	198	56.1	43.9
5	Barmash	129	117	246	52.4	47.6
6	Mollas	548	548	1096	50	50
7	Çlirim	56	48	104	53.8	46.2
8	Leskovik	465	474	939	49.5	50.5

Burimi: INSTAT

Ilustrimi grafik:



Analfabetizmi

Tabela më poshtë paraqet numrin e personave mbi 10 vjeç që dinë shkrim e lexim:

Emërtimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Banorë që nuk dinë shkrim e këndim	50	98	148	33.8	66.2
Banorë mbi 10 vjeç	3544	3381	6925	51.2	48.8

Burimi: INSTAT

Nga gjithsej **6,925 banorë mbi 10 vjeç** në Bashkinë Kolonjë, **148 persona rezultojnë se nuk dinë shkrim e lexim**, që përbën rreth **2.1%** të popullsisë në këtë grupmoshë. Brenda këtij grupi, **98 janë gra** dhe **50 janë burra**, çka do të thotë se **66.2%** e personave që nuk dinë shkrim e lexim janë gra, ndërsa **33.8%** janë burra.

Nëse krahasojmë këtë shpërndarje me përbërjen gjinore të popullsisë mbi 10 vjeç, ku **51.2% janë burra** dhe **48.8% janë gra**, vërehet një disproporcion i theksuar në dëm të grave. Megjithatë femrat përbëjnë pak më pak se gjysmën e popullsisë në këtë grupmoshë, ato përfaqësojnë një përqindje **shumë më të lartë** ndër personat që nuk kanë aftësi bazë në lexim dhe shkrim.

Kjo tregon se **gratë në Bashkinë Kolonjë janë më të prekura nga analfabetizmi**, gjë që mund të lidhet me faktorë si mosha, vendbanimi në zona të thella rurale, apo mungesa e mundësive për arsim në të kaluarën. Ky hendek përfaqëson një formë të pabarazisë gjinore në aksesin ndaj edukimit bazë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përfshirjen sociale dhe ekonomike të grave.

Analfabetizmi te gratë kufizon mundësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në tregun e punës, për të përfituar nga shërbimet publike dhe për të ushtruar të drejtat e tyre si qytetare. Prandaj, ky tregues nënvizon **nevojën për politika dhe programe të posaçme**, si arsimi për të rritur dhe fushata ndërgjegjësuere në komunitet, për të adresuar këtë pabarazi dhe për të fuqizuar gratë që janë lënë pas në arsimimin bazë.

Niveli Arsimit

Tabela më poshtë paraqet nivelin arsimor të popullatës.

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit, duke reflektuar tendenca sociale dhe sfida potenciale për barazinë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

#	Emërtimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Asnjë nivel arsimor i përfunduar	19	32	51	37.3	62.7
2	Arsimi Fillor	197	305	502	39.2	60.8
3	Shkollë 7/8/9 vjeçare	1360	1584	2944	46.2	53.8
4	Shkollë e mesme	1187	839	2026	58.6	41.4
5	Bachelor	150	167	317	47.3	52.7
6	Master ose Doktoraturë	220	195	415	53.0	47.0

Burimi: INSTAT

Të dhënat mbi **nivelin arsimor të popullatës së Bashkisë Kolonjë** tregojnë një shpërndarje gjinore që pasqyron dinamika të rëndësishme sociale dhe zhvillimore. Kjo analizë ndihmon për të kuptuar më mirë se ku ndodhen boshllëqet dhe cilat janë mundësitë për të avancuar **barazinë gjinore në arsim** dhe më gjerë.

Në kategorinë “**Asnjë nivel arsimor i përfunduar**” përfshihen **51 persona**, nga të cilët **62.7% janë gra** dhe **37.3% burra**. Gratë përbëjnë shumicën, duke treguar se ato kanë qenë më të ekspozuara ndaj mungesës së aksesit në arsim, sidomos në brezat më të vjetër apo në zonat më të izoluar.

Në nivelin e **arsimit fillor** janë **502 persona**, me **60.8% gra** dhe **39.2% burra**. Pjesëmarrja më e lartë e grave në këtë nivel sugjeron se shumë prej tyre e kanë ndërprerë shkollimin pas këtij cikli, ndoshta për shkak të kufizimeve sociale, ekonomike apo përgjegjësi të hershme familjare.

Në **arsimin 7/8/9-vjeçar (arsimi i detyrueshëm)** janë regjistruar **2,944 persona**, nga të cilët **53.8% janë gra** dhe **46.2% burra**. Ky nivel paraqet një shpërndarje më të barabartë midis gjinive, duke reflektuar përmirësim në përfshirjen e vajzave dhe djemve në arsimin bazë.


Në **arsimin e mesëm**, nga **2,026 persona** gjithsej, **58.6% janë burra** dhe **41.4% gra**. Ky ndryshim tregon një **rënie të ndjeshme të përfshirjes së vajzave** pas arsimit të detyrueshëm, çka mund të lidhet me mungesë mbështetjeje për vazhdimësinë e shkollimit ose barriera të tjera sociale dhe kulturore.

Në nivelin “**Bachelor**” janë **317 persona**, me **52.7% gra** dhe **47.3% burra**. Kjo sugjeron një **kthesë pozitive**: vajzat që arrijnë të përfundojnë arsimin e mesëm, kanë më shumë gjasa të vazhdojnë në arsimin e lartë, krahasuar me djemtë.

Në kategorinë “**Master ose Doktoraturë**” përfshihen **415 persona**, nga të cilët **53% janë burra** dhe **47% gra**. Megjithëse burrat janë pak më të shumtë, **pjesëmarrja e grave në këto nivele të larta arsimore është domethënëse** dhe tregon një prezencë të konsoliduar të tyre në arsimin akademik.

Në **përmbledhje**, të dhënat për Bashkinë Kolonjë tregojnë se **në nivelet e ulëta arsimore gratë janë më të prekura nga përjashtimi**, ndërsa **në arsimin e lartë dhe pasuniversitar ato arrijnë të tejkalojnë pengesat** dhe të përfaqësohen fuqishëm. Kjo dyzëzë sugjeron se duhet **më shumë mbështetje për mbajtjen e vajzave në arsimin e mesëm dhe tejkalimin e barrierave që ndalojnë përparimin e tyre në fazat e hershme të edukimit**.

Ilustrimi grafik:




Statusi martesor

Tabela më poshtë paraqet popullsinë mbi 10 vjeç sipas statusit martesor.

#	Emërtimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Beqar(e)	1204	736	1940	62.1	37.9
2	I/e martuar	2382	2357	4739	50.3	49.7
3	I/e divorcuar ose i/e ndarë	79	42	121	65.3	34.7
4	I/e ve	144	575	719	20.0	80.0

Burimi: INSTAT

Ilustrimi grafik:



Shpërndarja sipas statusit martesor në Bashkinë Kolonjë tregon dallime të theksuara gjinore, të cilat pasqyrojnë ndikimin e normave shoqërore, jetëgjatësisë dhe përvojave të ndryshme të grave dhe burrave në raport me martesën, divorcin dhe humbjen e partnerit.

Në kategorinë “beqar(e)”, nga gjithsej 1,940 persona, **62.1% janë burra** dhe **37.9% gra**. Burrat përbëjnë shumicën e beqarëve, çka mund të lidhet me faktin se ata priren të martohen më vonë se gratë ose të qëndrojnë më gjatë beqarë. Ky fenomen mund të ndikojë në mënyrën se si burrat përjetojnë rininë, karrierën dhe vendimmarrjen për krijimin e familjes.

Në kategorinë “i/e martuar”, janë regjistruar 4,739 persona, me një ndarje shumë të balancuar: **50.3% janë burra** dhe **49.7% gra**. Kjo tregon se martesat mbetet një institucion ku të dy gjinitë janë të përfshira në mënyrë të barabartë, të paktën në aspektin numerik. Një ndarje e tillë mund të jetë rezultat i martesave brenda të njëjtit komunitet dhe në moshë të përafërt, duke reflektuar stabilitetin e këtij statusi në Bashkinë Kolonjë.

Në kategorinë “i/e divorcuar” ose “i/e ndarë”, nga gjithsej 121 persona, **65.3% janë burra** dhe **34.7% gra**. Ndryshe nga tendenca kombëtare ku zakonisht gratë përfaqësojnë përqindje më të lartë të të divorcuarve, në Bashkinë Kolonjë burrat janë ata që dominojnë këtë kategori. Ky fakt mund të lidhet me mundësinë më të madhe të burrave për t’u rimartuar, vendimmarrjen më të shpejtë për ndarje ligjore, apo faktorë të tjerë që ndikojnë më shumë tek burrat në këtë komunitet rural.

Në kategorinë “i/e ve”, nga 719 persona, **80% janë gra** dhe vetëm **20% burra**. Ky është një dallim shumë i madh, i cili pasqyron realitetin biologjik dhe shoqëror: gratë kanë jetëgjatësi më të lartë se burrat dhe kanë më shumë gjasa të mos rimartohen pas vdekjes së bashkëshortit. Ky fenomen shfaqet dukshëm në moshat e treta dhe lidhet me ndjenjën e vetmisë, mungesën e të ardhurave të qëndrueshme dhe nevojën për shërbime sociale.

Kjo shpërndarje tregon se gratë e moshuara, veçanërisht të vejat, janë më të prekura nga izolimi dhe vështirësitë ekonomike, ndërsa përqindja më e lartë e burrave të divorcuar sugjeron një qasje më tradicionale ndaj ndarjes.

Të dhënat janë të rëndësishme për hartimin e politikave lokale që synojnë mbështetjen sociale dhe ekonomike për gratë e veja, përfshirjen e personave të divorcuar e beqarë, si dhe nxitjen e barazisë gjinore në jetën familjare.

Këto masa ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për grupet më të ndikuara nga statusi martesor dhe pabarazitë gjinore.


Statusi i nënës

Tabela më poshtë tregon numrin e femrave që bëhen nëna sipas grupmoshës:

Grupmosha	Kanë lindur	Nuk kanë lindur	Gjithsej	% kanë lindur	% NUK kanë lindur
15-24 vjeç	91	689	780	11.7	88.3
25-34 vjeç	501	226	727	68.9	31.1
35-44 vjeç	700	128	828	84.5	15.5
45-54 vjeç	1064	164	1228	86.6	13.4
55-64 vjeç	1412	196	1608	87.8	12.2
65-74 vjeç	970	101	1071	90.6	9.4
mbi 75 vjeç	573	38	611	93.8	6.2

Burimi: INSTAT

Ilustrimi grafik:



Të dhënat për Bashkinë Kolonjë tregojnë një shpërndarje të qartë të grave që kanë lindur fëmijë sipas grupmoshave, duke reflektuar si tendencat moderne, ashtu edhe normat tradicionale të brezave të mëparshëm.

Në grupmoshën 15–24 vjeç, vetëm **8.2%** e vajzave dhe grave kanë lindur fëmijë, ndërsa **91.8%** nuk kanë lindur. Kjo është një shifër shumë e ulët dhe përputhet me prirjet e reja që nxisin shtyrjen e moshës së parë të lindjes, ndoshta si pasojë e **ndjekjes së arsimit, përfshirjes në aktivitete sociale ose ekonomike**, apo edhe **mungesës së kushteve të favorshme për krijimin e familjes** në këtë moshë.

Në grupmoshën 25–34 vjeç, 62.4% e grave kanë lindur dhe 37.6% nuk kanë lindur. Ky grup përfaqëson **periudhën më aktive të jetës riprodhuese**. Megjithatë, përqindja e grave që nuk kanë lindur është ende relativisht e lartë, çka mund të lidhet me **emigrimin, pasigurinë ekonomike ose ndryshimet në qëndrimet ndaj prindërimit dhe rolit tradicional të gruas**.

Në grupmoshën 35–44 vjeç, 82% e grave kanë lindur fëmijë, ndërsa 18% nuk kanë lindur. Kjo tregon se **shumica dërrmuese e grave në këtë moshë kanë përmbushur rolin riprodhues**, por ende ekziston një përqindje e konsiderueshme që nuk kanë pasur fëmijë, ndoshta për **arsye personale, shëndetësore apo sociale**.

Në grupmoshën 45–54 vjeç, 88.8% e grave kanë lindur dhe 11.2% nuk kanë lindur. Kjo përqindje tregon se **në këtë grupmoshë lindshmëria ka qenë normë shoqërore**, por një pjesë e vogël e grave nuk kanë ndjekur këtë model, për arsye të ndryshme.

Në grupmoshat 55–64 vjeç, 65–74 vjeç dhe mbi 75 vjeç, përqindja e grave që kanë lindur fëmijë arrin nga 93% deri në 95.1%. Këto të dhëna pasqyrojnë **normat sociale të brezave të mëparshëm**, ku të pasurit fëmijë shihej si një detyrim shoqëror dhe një aspekt i rëndësishëm i identitetit të gruas.

Kjo shpërndarje tregon një ndryshim të qartë brezash. Gratë më të reja, veçanërisht ato nën 25 vjeç, kanë më shumë gjasa të mos kenë lindur ende. Kjo prirje mund të interpretohet si rezultat i rritjes së nivelit arsimor, rritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës, aspiratave të reja personale, si dhe ndryshimeve në strukturat dhe rolet tradicionale familjare.

Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar më mirë nevojat specifike të grave në faza të ndryshme të jetës.

- Gratë e reja mund të kenë nevojë për mbështetje në planifikimin familjar, akses në informacion mbi shëndetin riprodhues, si dhe politika që lehtësojnë balancimin midis karrierës dhe jetës familjare.
- Gratë në moshë më të avancuar, që janë ose kanë qenë nëna, mund të kenë nevojë për mbështetje në aspektet e kujdesit për fëmijët, përfitimeve sociale, ose përballimin e sfidave të fazave të tjera të jetës familjare.


Frekuentimi i Çerdhes

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin çerdhen.

#	Emërtimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek Çerdhen	16	28	44	36.4	63.6
2	NUK ndjek çerdhen	40	44	84	47.6	52.4

Burimi: INSTAT

Ilustrimi grafik:



Nga gjithsej **128 fëmijë të moshës 0–3 vjeç** në territorin e **Bashkisë Kolonjë**, **44 fëmijë** (rreth **34.4%**) ndjekin çerdhen, ndërsa **84 fëmijë** (rreth **65.6%**) nuk ndjekin.

Ndër fëmijët që ndjekin çerdhen, **36.4% janë djem** dhe **63.6% vajza**. Kjo shpërndarje sugjeron një **prani më të lartë të vajzave** në çerdhe, ndryshe nga modelet më të zakonshme ku shpërndarja është më e barabartë. Megjithatë, për shkak të numrit relativisht të vogël të fëmijëve, kjo diferencë mund të lidhet me faktorë lokalë apo specifikë familjarë dhe jo domosdoshmërisht me një prirje gjinore sistematike.

Ndër fëmijët që **nuk ndjekin çerdhen**, **47.6% janë djem** dhe **52.4% vajza**, çka tregon një shpërndarje më të balancuar, pa dallime të theksuara gjinore në këtë kategori.

Ajo që bie në sy është se **vetëm rreth 1 në 3 fëmijë** të kësaj grupmoshe ndjekin çerdhen në Kolonjë, ndërsa pjesa më e madhe (**dy të tretat**) nuk përfitojnë nga ky shërbim. Kjo përqindje e ulët mund të jetë rezultat i **mungesës së kapaciteteve, numrit të kufizuar**

të institucioneve të çerdhes, kostove të mundshme për familjet, apo normave kulturore që preferojnë kujdesin familjar, veçanërisht nga nëna ose gjyshërit.

Kjo situatë ka **implikime të rëndësishme për barazinë gjinore**, pasi **mospërfshirja në çerdhe ndikon në mundësitë e prindërve**, veçanërisht **të grave**, për të ndjekur **punësimin, arsimimin**, apo për të qenë **aktive në jetën publike**. Në kontekstin e mungesës së shërbimeve të kujdesit institucional, **është zakonisht gruaja ajo që mbart barrën kryesore të kujdesit për fëmijët**, duke kufizuar ndjeshëm angazhimin e saj jashtë shtëpisë.

Për këtë arsye, të dhënat tregojnë një **nevojë për rritjen e mbulimit me shërbime çerdhjeje në Kolonjë**, si dhe për **politika mbështetëse që e bëjnë këtë shërbim më të aksesueshëm për familjet**, në mënyrë që të **lehtësohet balanca mes jetës familjare dhe asaj profesionale**, sidomos për gratë. Kjo do të përfaqësonte një **masë konkrete për promovimin e barazisë gjinore** dhe për fuqizimin ekonomik dhe social të familjeve në zonat rurale si Kolonja.

Frekuentimi i Kopshtit

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që ndjekin kopshtin:

#	Frekuentimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek kopshtin	54	53	107	50.5	49.5
2	NUK ndjek kopshtin			0	0	0

Burimi: INSTAT

Të dhënat për Bashkinë Kolonjë tregojnë se **të gjithë fëmijët e moshës përkatëse ndjekin kopshtin**, pasi **nuk ka asnjë fëmijë të regjistruar në kategorinë “Nuk ndjek kopshtin”**. Në total, **107 fëmijë** ndjekin kopshtin, nga të cilët **54 janë meshkuj** (50.5%) dhe **53 janë femra** (49.5%).

Shpërndarja është thuajse e barabartë ndërmjet gjinive, gjë që tregon një **akses të drejtë dhe të balancuar në arsimin parashkollor** për vajzat dhe djemtë në këtë bashki. **Nuk ka asnjë tregues të pabarazisë gjinore** në këtë fazë të edukimit formal, çka përbën një shembull pozitiv në kontekstin e realitetit shqiptar, ku shpesh vihet re mospërfshirje më e lartë e vajzave në çerdhe dhe kopshte.

Fakti që **nuk ka asnjë fëmijë të lënë jashtë sistemit të edukimit parashkollor** është shumë domethënëse. Ai sugjeron se në Bashkinë Kolonjë:

- Kapacitetet e institucioneve parashkollore janë të mjaftueshme për të përfshirë të gjithë fëmijët e kësaj moshe;
- Kujdesi institucional ndaj fëmijëve të vegjël është në funksion të plotë, duke lehtësuar barrën e kujdesit nga familjet, në veçanti nga gratë;
- Nënata kanë më shumë mundësi të angazhohen në tregun e punës, arsim apo aktivitete të tjera publike dhe ekonomike, pasi fëmijët janë të përfshirë në shërbime të strukturuar të kujdesit dhe edukimit.

Ky model funksionimi, ku **përfshirja në kopshte është universale dhe gjinoreisht e barabartë**, duhet të **vlerësohet dhe promovohet si praktikë e mirë**, duke u shtrirë edhe në bashkitë e tjera ku kjo balancë nuk është arritur ende.

Në këtë kuptim, **Bashkia Kolonjë ofron një shembull konkret** të asaj se si **arsimi parashkollor mund të kontribuojë drejtpërdrejt në barazinë gjinore**, në mbështetjen e prindërve, dhe në fuqizimin e grave në aspektin social dhe ekonomik. Ruajtja dhe forcimi i këtij standardi duhet të jetë një prioritet në politikat vendore, me investime të qëndrueshme dhe vëmendje të veçantë ndaj vazhdimësisë së aksesit të barabartë në edukim që në hapat e parë të jetës.


Persona me Aftësi të Kufizuar

Tabelat më poshtë tregojnë numrin total të personave me aftësi të kufizuar në bashki dhe të ndarë sipas llojit të vështirësisë:

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
5-14 vjeç	5		5	100	0
15-64 vjeç	106	144	250	42.4	57.6
mbi 65 vjeç	252	294	546	46.2	53.8

Burimi: INSTAT

Ilustrimi grafik:



Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kolonjë tregojnë një prirje të qartë gjinore që ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë dhe përfshirjen sociale të grave. Në grupmoshën 5–14 vjeç, numri i grave me aftësi të kufizuara është shumë i ulët (madje zero në këtë rast), ndërsa tek grupmosha 15–64 vjeç, gratë përbëjnë 57.6% të personave me aftësi të kufizuara, dhe mbi 65 vjeç 53.8%. Kjo tregon se me rritjen e moshës, përqindja e grave me aftësi të kufizuara rritet ndjeshëm.

Në analizën sipas llojit të vështirësisë, gratë përfaqësojnë përqindjen më të madhe në pothuajse të gjitha kategoritë: në ecje (56.9%), në komunikim (55.6%), në kujdesin ndaj vetes (52.9%), në kujtesë (53%), në dëgjim (52%) dhe në shikim (50.7%). Kjo tregon se gratë me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të shumta fizike, ekonomike dhe kulturore.


Kjo situatë ka ndikim të dyfishtë për gratë – si gra dhe si persona me aftësi të kufizuara – duke i kufizuar ato në aksesin në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe jetë të pavarur.

Të dhënat tregojnë nevojën për politika sociale dhe plane barazie gjinore që adresojnë sfidat specifike të grave me aftësi të kufizuara. Bashkia Kolonjë duhet të ndërmarrë masa për të siguruar infrastrukturë të aksesueshme, mbështetje për kujdesin personal dhe shëndetësor, përfshirje në tregun e punës dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna, për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

#	Lloji i vështirësisë	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Në shikim	144	148	292	49.3	50.7
2	Në dëgjim	109	118	227	48.0	52.0
3	Në ecje	225	297	522	43.1	56.9
4	Kujtesë	71	80	151	47.0	53.0
5	Kujdesin e përditshëm ndaj vetes	88	99	187	47.1	52.9
6	Në komunikim	52	65	117	44.4	55.6

Burimi: INSTAT

Ilustrimi grafik:



Punëkërkesit e papunë sipas njësive administrative


Të dhënat e mbledhura mbi **numrin e punëkërkesve të papunë** tregojnë një shpërndarje të pabarabartë të fenomenit të papunësisë brenda njësive administrative të bashkisë. Në total, janë regjistruar **135 punëkërkes të papunë**, me përqendrim të dukshme në disa zona specifike.

Njësitë me numër të lartë punëkërkesish:

- **Ersekë** mban vendin e parë me **46 punëkërkes të papunë**, duke reflektuar një përqendrim të lartë të personave në kërkim të punës në zonën urbane. Si qendër administrative, kjo mund të lidhet me migrimin e brendshëm nga zonat rurale drejt qytetit në kërkim të mundësive më të mira ekonomike.
- **Qendër Ersekë**, me **43 punëkërkes**, ndjek nga afër, duke treguar se sfidat e punësimit janë të përhapura edhe në zonat përreth qytetit kryesor.
- **Mollas**, me **24 punëkërkes**, përfaqëson një njësi rurale me nivel të lartë papunësie, çka sugjeron mungesë të mundësive ekonomike dhe nevojë për ndërhyrje të drejtpërdrejtë për nxitjen e punësimit lokal.

Njësitë me nivel të ulët punëkërkesish:


- **Barmash (1), Qendër Leskovic (2) dhe Novoselë (4)** paraqesin numra më të ulët, të cilët mund të interpretohen në disa mënyra:
 - Popullsia më e vogël dhe e shpërndarë, që reflekton automatikisht një numër më të ulët punëkërkesish.
 - Mundësi informale punësimi, që nuk regjistrohen si punëkërkes zyrtarë.
 - Mungesë qasjeje ndaj zyrave të punës dhe informacionit për regjistrim, veçanërisht në zonat më të largëta dhe rurale.



Punëkërkesit e papunë sipas Gjinisë

Të dhënat tregojnë se meshkujt përbëjnë rreth 65% të punëkërkesve të papunë, ndërsa femrat përfaqësojnë rreth 35%. Ky raport mund të tregojë se:

- Burrat janë më të përfshirë në sektorë me punësim sezonal ose informal, të cilët preken më shpejt nga papunësia.
- Femrat mund të mos raportohen si punëkërkuese për arsye sociale, kulturore apo familjare (p.sh., kujdes për fëmijët), edhe pse realisht janë jashtë tregut të punës.



Në analizën e Planit Social ose të politikave aktive të punësimit, **është e rëndësishme të merren parasysh dallimet gjinore**, për të ndërtuar masa të drejta dhe gjithëpërfshirëse.

Grupet Vulnerabël të Punëkërkuessve të Papunë

Të dhënat tregojnë një **pjesëmarrje të ulët ose të papërfaqësuar** të disa kategorive të veçanta në tregun e punës, konkretisht:

- **Rome/Egjiptianë – 0 punëkërkuess të papunë të regjistruar:**
Kjo mungesë e të dhënave nuk duhet interpretuar si mungesë nevojë për punësim, por më shumë si **mungesë përfshirjeje në sistemin formal të punësimit**. Shpesh, anëtarët e këtyre komuniteteve nuk regjistrohen në zyrat e punës për shkak të:
 - Mungesës së informacionit dhe aksesit;
 - Mosbesimit ndaj institucioneve publike;
 - Apo angazhimit në ekonomi informale apo të vetëpunësuar jo të formalizuar.
- **Kryefamiljare gra – 8 punëkërkuess:**
Ky grup përfaqëson një ndër kategoritë më të rrezikuara nga marginalizimi social dhe ekonomik. Kryefamiljaret gra shpesh përballen me barriera të shumta për punësim, përfshirë:

- Mungesë mbështetjeje për kujdesin ndaj fëmijëve;
- Mungesë trajnimesh ose njohurish për tregun e punës;
- Diskriminim gjinor në aksesin ndaj vendeve të punës.
- **Emigrantë – 1 punëkërkes:**
Ky numër shumë i ulët mund të sinjalizojë një grup të vogël të pranishëm në komunitet, por gjithashtu edhe një **mosregjistrim të emigrantëve që janë në kërkim pune**, shpesh për shkak të statusit të paformalizuar apo mungesës së dokumentacionit të plotë.
- **Persona me aftësi të kufizuara (PAK) – 1 punëkërkes:**
Edhe pse përfaqësimi është minimal, ky numër tregon që ekziston një individ me Aftësi të Kufizuara që është aktivisht në kërkim pune. Sidoqoftë, **mungesa e mbështetjes së strukturuar, punëve të përshtatura dhe barrierave sociale** e bën pjesëmarrjen e PAK-ve në tregun e punës shumë të vështirë.

Trajnimet Profesionale

Zyra e punës ka organizuar gjithsej **3 trajnime profesionale** gjatë periudhës raportuese (2024), me një **pjesëmarrje prej 41 individësh**, që përbën një mesatare prej rreth 14 pjesëmarrës për trajnim. Kjo tregon një angazhim pozitiv në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të punëkërkesve dhe përgatitjes së tyre për tregun e punës.

Këto trajnime përfaqësojnë një instrument të rëndësishëm për:

- Rritjen e mundësive për punësim, veçanërisht për personat pa arsim profesional ose me përvojë të kufizuar pune;
- Fuqizimin ekonomik të grupeve vulnerabël, nëse trajnimet janë të orientuara drejt nevojave të tyre;
- Ndërveprimin me sektorin privat, nëse programet zhvillohen në partneritet me punëdhënës potencialë.

Bizneset në territorin e Bashkisë Kolonjë

1. Formalizimi i bizneseve

Nga 244 biznese gjithsej, **207 janë biznese të vogla të regjistruara formalisht**, që përbën një përqindje të lartë të formalizimit në segmentin e bizneseve të vogla (~85%). Kjo tregon një **nivel të mirë të regjistrimit dhe deklarimit fiskal**.

2. Prezenca e informalitetit

Janë evidentuar **10 biznese informale**, që megjithëse përfaqësojnë një përqindje relativisht të ulët (~4%), përbëjnë një sinjal për **monitorim të mëtejshëm** dhe ndërhyrje për edukim dhe mbështetje për legalizim.

3. Qarkullimi i bizneseve

Me 28 biznese të mbyllura brenda një viti, përkundër 230 të regjistruarave deri

në fund të vitit, tregohet një **nivel i caktuar lëvizshmërie ekonomike**, që mund të jetë pasojë e vështirësive në mjedisin ekonomik lokal, mungesës së tregut, apo kushteve të tjera operationale.


4. Fushat kryesore të aktivitetit

Aktiviteti ekonomik është i **koncentruar kryesisht në sektorin e shërbimeve**:

- **Bar-Kafe**

- **Ushqimore**

Kjo reflekton strukturën konsumatore të territorit dhe mungesën e diversifikimit ekonomik në fusha të tjera si prodhimi, bujqësia përpunuese apo turizmi rural.



Të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve sipas njësive administrative në Bashkinë Kolonjë tregojnë një përqendrim të lartë në zonën urbane të **Ersekës**, me **167 biznese të regjistruara**, që përfaqësojnë mbi 68% të totalit të bizneseve në territor. Kjo është tregues i qartë i rolit të Ersekës si qendër ekonomike dhe administrative.

Në zonat rurale si **Mollas (13 biznese)**, **Qendër Leskovik (14 biznese)** dhe **Leskovik (39 biznese)**, ekziston një aktivitet modest ekonomik, ndërsa njësitë si **Çlirim** dhe **Novoselë** nuk raportojnë asnjë biznes të regjistruar, duke sinjalizuar për përjashtim ekonomik dhe nevojë për politika mbështetëse që nxisin sipërmarrjen.

Kjo shpërndarje e pabarabartë e bizneseve sugjeron nevojën për ndërhyrje të synuara për të mbështetur zhvillimin ekonomik në zonat më pak të zhvilluara, përmes subvencioneve, lehtësive fiskale apo ngritjes së qendrave mbështetëse për biznesin.

Metodologjia

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikën më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e bashkisë, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmoshave, niveli arsimor, normat e analfabetizmit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuar, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit.

Analiza mori gjithashtu në konsideratë diferencat midis zonave urbane dhe rurale të territorit të bashkisë, për të kuptuar nëse sfidat gjinore janë homogjene apo të ndikuara nga konteksti gjeografik dhe social. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e nevojave të ndryshme në nivel njësie administrative dhe krijoi bazën për përshtatjen e ndërhyrjeve në planin e veprimit.

Në aspektin institucional, u analizua struktura ekzistuese dhe funksionaliteti i mekanizmave për barazinë gjinore brenda bashkisë. Konkretisht, u shqyrtua nëse bashkia kishte miratuar Kartën për Barazinë Gjinore, nëse Komisioni për Barazi Gjinore pranë Këshillit Bashkiak ishte funksional, dhe nëse Aleanca e Grave Këshilltare ishte aktive dhe me mbështetje buxhetore. Po ashtu, u vlerësua ekzistenca dhe roli i punonjësit të barazisë gjinore brenda administratës, pozicionimi i tij në strukturë (veçmas apo i lidhur me dhunën në familje), dhe çfarë roli dhe detyrash janë përcaktuar në përshkrimet e punës apo në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë ka qenë edhe vlerësimi i kapacitetit për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet publike, përmes ngritjes së një Komisioni të Administratës për Barazi Gjinore. U vlerësua nëse komisioni ekziston, është ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologji ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.

Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, Bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

Qëllimet dhe objektivat strategjike

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë Kolonjë 2026–2028 ndërtohet mbi **dy qëllime strategjike**, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Këto qëllime janë të përkthyer në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, që mund të zbatohen, monitorohen dhe matën përgjatë një periudhe trevjeçare.

Qëllimi Strategjik 1 (Q1):

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon të konsolidojë qeverisjen vendore duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një komponent funksional dhe të domosdoshëm të mënyrës se si organizohen, menaxhohen dhe zhvillohet Bashkia. Në këtë kuadër, barazia gjinore nuk konceptohet si një qëllim i izoluar, por si një qasje ndërsektoriale që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse, planifikuese, menaxheriale dhe raportuese të qeverisjes vendore.

Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet që zhvillohen nga institucionet publike, si dhe në mënyrën se si komunikohet dhe bashkëpunohet me qytetarët. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e mekanizmave të brendshëm për monitorim dhe llogaridhënie, si dhe fuqizimin e rolit të aktorëve vendor, përfshirë këshillat bashkiakë, administratën vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin, në promovimin e barazisë gjinore si një element i padiskutueshëm i qeverisjes së mirë.

Qëllimi Strategjik 1 përfshin tre objektiva specifike:

- **1.1.** Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të raportimit publik mbi progresin për barazinë gjinore, duke përdorur të dhëna gjinore dhe platforma digjitale.
- **1.2.** Fuqizimi i mekanizmave institucionale lokale që merren me çështjet gjinore, përmes ngritjes së strukturave përfaqësuese, trajnimeve dhe rregulloreve funksionale.
- **1.3.** Nxitja dhe zgjerimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet me komunitetin.

Qëllimi Strategjik 2 (Q2):

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cenueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Ky qëllim kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

Qëllimi Strategjik 2 konkretizohet në katër objektiva specifikë:

- **2.1.** Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike.
- **2.2.** Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
- **2.3.** Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm.
- **2.4.** Promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbajtjes dhe pjesëmarrjes së barabartë.

5. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi strategjik 1:

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Objektivi Specifik (O1.1) Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.					
Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë dhe të KBRE-së.	2026	Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare ëeb të bashkisë; IT I/e bashkisë	Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare	5,000 lekë (faqe ëeb, staf teknik)	Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare
1.1.2 Hartimi i udhëzimeve dhe tabelave të treguesve për monitorim.	2026	Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e performancës	Njësia përgjegjëse për hartimin e statistikave/performancës	90,000 lekë(dizajnim + printim udhëzues)	Dokument i përfunduar dhe shpërndarë në drejtoritë përkatëse
1.1.3. Njohja me instrumentet matëse për mbledhjen e të dhënave.	2026	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT, donatorë		Numri i punonjësve të njohur me instrumentat matëse për mbledhje e të dhënave.
1.14. Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të	2026 - 2028	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT, donatorë	180,000 lekë (trajnerë + logjistikë)	Numri i punonjësve të trajnuar dhe

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

dhënave me tregues gjinorë.					vlerësimi pas-trajnit
1.1.5 Krijimi i një platforme online të hapur për publikimin e statistikave dhe konsultime publike për masat për barazinë gjinore në Bashki	2026 - 2027	IT I/e bashkisë	AKSHI, Shoqëria Civile	450,000 lekë (zhvillim platforme, miëmbajtje 1 vit)	Platforma funksionale dhe numri i përdoruesve aktivë
1.4.6 Përfshirja në rubrikën përkatëse të seksionit për konsultime publike për buxhetimin dhe nxitjen e pjesëmarrjen gjinore	2026	Njësia përgjegjëse për hartimin Buxhetit Afatmesëm	Njësitë Administrative, Gra Këshilltare	60,000 lekë (takime + publikime informative)	Seksioni funksional dhe pjesë-marrje gjinore në konsultime
1.4.7 Kalendar Lokal dhe organizim i aktiviteteve për Ditët Ndërkombëtare të të Drejtave të Grave	Viti 2026 (i përsëritshëm çdo vit)	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, OJF lokale, media	120,000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i aktiviteteve të organizuara sipas kalendarit
1.4.8 Sistem i integruar dixhital për mbledhjen dhe analizën gjinore të të dhënave në nivel lokal	2027 – 2028	IT dhe Përgjegjësit/drejtuesit e drejtorive/sectorëve në bashki	INSTAT, partnerë teknikë, ekspertë të fushës	700,000 lekë (zhvillim sistemi + trajnime)	Sistem funksional, numri i të dhënave të përpunuara gjinor

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

1.4.9. Organizimi i tryezave vjetore të konsultimit me komunitetin dhe aktorët lokalë mbi progresin e planit dhe të dhënat gjinore të publikuara.	2026 - 2028	Zyra për Barazi Gjinore pranë Bashkisë, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun / Transparencës dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Projekteve	Këshilli Vendor për Barazinë Gjinore (nëse ekziston), Organizata të shoqërisë civile locale, Institucionet arsimore dhe grupe të komunitetit		Numri i takimeve të organizuara me komunitetin dhe aktorët lokalë mbi progresin e planit.
1.4.10. Angazhimi i të rinjve, grupeve qytetare dhe OJF-ve lokale në mbikëqyrjen e buxhetimit të ndjeshëm gjinor përmes "grupeve vëzhguese" ose iniciativave për transparencë.	2026 - 2028	Zyra për Barazi Gjinore	Qendrat komunitare dhe rinore në territorin e bashkisë OJF që punojnë për transparencën, pjesëmarrjen qytetare dhe barazinë gjinore (p.sh. Qendra për të Drejtat e Grave, Qendra Rinore, etj.) Fakultetet/institucionet arsimore që kanë klube rinore apo departamente të shkencave sociale.		Numri i grupeve vëzhguese të ngritura dhe/ose aktiviteteve të ndërmarra nga të rinjtë, grupet qytetare dhe OJF-të për të monitoruar dhe promovuar buxhetimin e ndjeshëm gjinor në nivel vendor.
1.4.11. Prezantimi dhe shpërndarja e të dhënave gjinore mbi progresin e barazisë gjinore, përmes platformave digjitale dhe kanaleve	2026 - 2028	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit / IT, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Njësitë	Organizatave të shoqërisë civile që punojnë për barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen qytetare, Partnerëve teknikë dhe donatorëve.		Numri i publikimeve me të dhëna gjinore mbi progresin e barazisë gjinore të shpërndara në platforma digjitale dhe

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

tradicionale të komunikimit publikun.		Administrative dhe Qendrat Komunitare			media tradicionale.
---------------------------------------	--	---------------------------------------	--	--	---------------------

Objektivi Specifik (O1.2) Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.					
Aktivitete	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.2.1 Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të strukturs përgjegjëse për barazinë gjinore në Bashki (Njësia për barazinë gjinore)	2026	Njësia përgjegjëse për Burimet Njerëzore & Kryetar i Bashkisë	Donatorë	200,000 lekë (strukturim, materiale, orë pune)	Struktura funksionale dhe e pajisur me burime njerëzore
1.2.2 Ngritja e funksionalizimi i Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie.(ekzekutivi)	2026	Kryetari i Bashkisë	Drejtuesit e Drejtorive, Këshilli Bashkiak	80,000 lekë (mbledhje, dokumente, koordinim, orë pune)	Komisioni aktiv dhe mbledhje periodike të dokumentuara
1.2.3 Trajnim për anëtarët e Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie. (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.	2026	Nësia përgjegjëse për Barazi Gjinore	Donatorë, ekspertë të kontraktuar	100,000 lekë (trajnerë, logjistikë, materiale)	Numri i trajnimeve dhe përfshirja e anëtarëve
1.2.4 Program trajnimi për zyrtarët bashkiakë mbi barazinë gjinore dhe anti-diskriminimin sipas një kalendari vjetor të miratuar.	2026 - 2028	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Shkolla e Administratës Publike, OJF	300,000 lekë/vit (paketa trajnuese, fasilitatorë, certifikime)	Numri i trajnimeve të zhvilluara sipas kalendarit vjetor

Objektivi Specifik (O1.3) Të nxitet dhe zgjerohet pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, në nivel lokal.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.3.1 Takime informuese me administratorët shoqërorë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesa.	2026	Njësia përgjegjëse për shërbimet Sociale	Njësia Administrative, Njësia përgjegjëse për Barazinë gjinore në bashki (punonjësi i barazisë gjinore)	75,000 lekë (organizim, materiale, orë pune)	Numri i takimeve dhe pjesëmarrësve përfaqësues
1.3.2 Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rolet gjinore në komunitete rurale dhe lagje urbane	2026 - 2028	Njësia Administrative, Njësia përgjegjëse për Barazinë gjinore në bashki (punonjësi i barazisë gjinore)	OJF lokale, shkolla, grupet e interesit	150,000 lekë (postera, aktivitete, facilitim, orë pune)	Numri i fushatave dhe zonat e mbuluara
1.3.3 Organizimi i fushatave të komunikimit gjinor me media lokale dhe shkolla	2026 - 2028	Drejtoria e Komunikimit dhe Arsimit	Media lokale, ZVA Kolonjë, OJF	180,000 lekë (video, përmbajtje edukative, publikime)	Numri i fushatave të zhvilluara në media dhe shkolla
1.3.4 Organizimi i konsultimeve periodike dhe të rregullta me organizatat e grave dhe grupet në nevojë për probleme dhe sfida në ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike lokale;	2026 e në vijim	Zyra për Marrëdhënie me Komunitetin	OJF, grupime komunitare, përfaqësues të shërbimeve	120,000 lekë/vit (takime, raporte, koordinim, orë pune)	Numri i konsultimeve dhe temat e adresuara në shërbimet publike

Qëllimi strategjik 2:

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë Kolonjë.

Objektivi Specifik (O2.1) Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.					
Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të NJVRR (Njësitë Vendore të Referimit dhe Reagimit) për çdo njësi administrative	2026	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale	Njësitë Administrative, Njësia përgjegjëse për barazinë gjinore në bashki (Koordinatori i barazisë gjinore) Policia, Shërbimi Shëndetësor	350,000 lekë (formim strukturash, trajnime, logjistikë, orë pune)	Numri i strukturave NJVRR të ngritura dhe funksionale në njësi administrative
2.1.2 Zhvillimi i një programi vjetor me mbështetjeje financiare me grante të vogla për gratë dhe vajzat, që synojnë të nxisin iniciativa sociale, ekonomike apo biznese të vogla (veçanërisht në zonat rurale).	2026-2028	Njësia përgjegjëse për Zhvillimin Ekonomik dhe Bujqësisë	Agjencia e Zhvillimit Rajonal, Donatorë, OJF ekonomike	1,200,000 lekë/3 vite (fond për grante, promocion, ndihmë teknike, lehtësi fiskale)	Numri i granteve të dhëna; % e përfituesve nga zonat rurale

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

2.1.3 Krijimi dhe zhvillimi i hapësirave komunitare të dedikuara për Gratë dhe Vajzat në çdo njësi administrative.	2026-2027	Njësitë përgjegjëse për Infrastrukturën, shërbimet publike, & ndjekjen e investimeve në bashki	Njësitë Administrative, Arkitektë, Shoqata komunitare	700,000 lekë (mobilitet, ambiente, mirëmbajtje fillestare)	Numri i hapësirave të hapura dhe frekuentimi i tyre
2.1.4 Zhvillimi i moduleve të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në bashkëpunim me ZVA dhe shkollat fillore	2026-2027	Njësia përgjegjëse për Barazinë gjinore në bashki (Koordinator i barazisë gjinore)	ZVA Kolonjë, OJF edukative, mësues të përzgjedhur	180,000 lekë (modulim materiale, trajnim i mësuesve, monitorim)	Numri i moduleve të zhvilluara dhe numri i shkollave pjesëmarrëse
2.1.5 Organizimi i konsultimeve dhe hulumtimeve lokale për identifikimin e nevojave, preferencave dhe sfidave të grave dhe vajzave në secilën njësi administrative, në mënyrë që të hartohen hapësira komunitare që ofrojnë mbështetje efektive dhe të përshtatura për ta.	2026 - 2028	Organizim i sondazheve dhe intervistave me përfaqësues të komunitetit dhe grupeve të ndryshme të grave dhe vajzave në secilën NjA. Mbledhje të të dhënave përmes fokus-grupesh dhe takimesh konsultative me aktorë lokalë Analizë dhe raportim i rezultateve për të	Njësitë Administrative lokale përgjegjëse për zhvillimin social dhe komunitar. Departamenti për Barazinë Gjinore në Bashki.		Numri i konsultimeve dhe hulumtimeve të realizuara në nivel lokal për identifikimin e nevojave të grave dhe vajzave në njësitë administrative.

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

		nxjerrë konkluzione mbi nevojat dhe prioritetet për hapësira komunitare. Përdorimi i platformave dixhitale për shpërndarjen e pyetësorëve dhe mbledhjen e feedback-ut në mënyrë gjithëpërfshirëse.			
2.1.6 Hartimi i një hartë interaktive të shërbimeve publike të ndjeshme ndaj gjinisë, për të evidentuar aksesin, shpërndarjen gjeografike dhe përballueshmërinë e tyre në të gjitha zonat e bashkisë.	2026 - 2028				Harta interaktive e shërbimeve publike të ndjeshme ndaj gjinisë është hartuar dhe publikuar.
2.1.7 Trajnime të stafit të shërbimeve publike (shëndetësi, arsim, shërbime sociale,	2026 - 2028				Numri i punonjësve të shërbimeve publike të trajnuar mbi

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

urbanistikë, etj.) mbi ndjeshmërinë gjinore dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta					ndjeshmërinë gjinore dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta.
2.1.8 Përmirësimi i infrastrukturës në shkolla, qendra shëndetësore dhe hapësira publike, për të siguruar akses të barabartë për gratë, vajzat, personat me aftësi të kufizuar dhe grupet e marginalizuara (p.sh. tualete të ndara, ndriçim publik, rrugë të sigurta).	2026 - 2028				Numri i institucioneve dhe hapësirave publike ku është përmirësuar infrastruktura për të siguruar akses të barabartë për gratë, vajzat, personat me aftësi të kufizuar dhe grupet e marginalizuara.

Objektivi Specifik (O2.2) Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinor dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.					
Aktivitetet	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokolli të ndjeshëm gjinor për reagim në raste pandemie, fatkeqësi natyrore ose kriza civile	2025	Njësia përgjegjëse për shërbimet e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Shëndetësisë	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale; Qendra Shëndetësore, OJF, Ministria e Shëndetësisë	200,000 lekë (ekspertizë ligjore dhe sociale, konsultime)	Dokument protokolli i miratuar dhe i shpërndarë në strukturat vendore
2.2.2 Konsulencë ligjore falas për çështjet e diskriminimit gjinor;	2025–2027	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale	Qendra Ligjore e Ndihmës Falas, OJF për të drejtat e grave	250,000 lekë/vit (pagesa për ekspertë, zyra këshillimi, informim publik)	Numri i rasteve të trajtuara dhe këshillimeve të ofruara
2.2.3 Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale falas për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës dhe diskriminimit gjinor	2026 - 2028	Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë Psikologë dhe punonjës socialë të trajnuar në bashkëpunim me partnerë të shoqërisë civile Qendra Sociale			Numri i grave dhe vajzave viktimat të dhunës ose diskriminimit gjinor që kanë përfituar shërbime psiko-sociale falas.

Objektivi Specifik (O2.3) Të përmirësohet siguria dhe cilësia e jetës në hapësirat publike urbane dhe rurale, përmes dizajnit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe krijimit të mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë.

Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.3.1 Zbatimi i nismes ‘Qytete të sigurta për grate, vajzat dhe grupet në nevojë’ në 3 lagje pilot përmes ndriçimit, sinjalistikës dhe shenjimit të hapësirave publike të sigurta	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për projektet e Urbanistikës dhe Infrastrukturës	Policia Bashkiake, OJF për të drejtat e grave	1,000,000 lekë (projekt teknik, ndriçim, sinjalistikë, promovim, orë pune)	Numri i lagjeve të përfshira dhe ndërhyrjet infrastrukturore të realizuara

Objektivi Specifik (O2.4) Të sigurohet përfshirja e barabartë dhe gjithëpërfshirëse gjinore në jetën kulturore, letrare dhe sportive të komunitetit, duke garantuar akses të drejtë në infrastrukturë, përmbajtje promovuese dhe programe pjesëmarrëse për të gjitha grupet – gratë, burrat, vajzat, djemtë, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe komunitete vulnerabël.					
Aktivitetet	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.4.1 Pasurimi i fondit të bibliotekës me libra që theksojnë rolin pozitiv të grave dhe burrave në fusha të ndryshme, si dhe promovimi i leximit të barabartë gjinor përmes klubeve të leximit	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse Kulturën dhe Arsimin	Biblioteka e qytetit, ZVA, OJF kulturore	120,000 lekë (blerje librash, promovim, aktivitete, orë pune)	Numri i librave të blerë; numri i aktiviteteve të leximit
2.4.2 Promovimi i klubeve të leximit për barazi gjinore	2026 - 2028	Biblioteka dhe Njësia përgjegjëse Barazinë Gjinore (Koordinator)	Shkolla, OJF, klube rinore	80,000 lekë (materiale, lexim i drejtuar, takime diskutimi, orë pune)	Numri i klubeve funksionale dhe pjesëmarrësve (sipas gjinisë)
2.4.3 Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në veprimtari kulturore e sportive përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe programeve të përshtatura të ndjeshme ndaj gjinisë	2026 -2028	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Klube sportive, Njësitë Administrative, komuniteti	900,000 lekë (rindërtime të vogla, programe, trajnime)	% e grave dhe burrave që marrin pjesë në aktivitete; numri i ambienteve të përshtatura
2.4.4 Klube letrare & sportive me përfshirje gjithëpërfshirëse	2026 - 2028				Numri i klubeve letrare dhe sportive të krijuara me

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2028

Krijim klubi leximi, futbolli, vallëzimi apo korti që synojnë pjesëmarrje të barabartë; përfshijnë programe të dedikuara për vajza në zona rurale /urbana si dhe persona me nevoja të veçanta.					përfshirje gjithëpërfshirëse (vajza, persona me nevoja të veçanta, zona rurale dhe urbane).
2.4.5 Trajnime për organizatorët lokalë dhe staf institucional mbi përfshirjen gjithëpërfshirëse dhe ndjeshmërinë ndaj barazisë gjinore.	2026 - 2028				Numri i organizatorëve lokalë dhe punonjësve institucionalë të trajnuar mbi përfshirjen gjithëpërfshirëse dhe ndjeshmërinë ndaj barazisë gjinore.

Monitorimi dhe Raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

6.1 Monitorimi dhe Raportimi

Zbatimi i **Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028** do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, që siguron:

1. **Ndjekje në kohë reale** të progresit;
2. **Evidentim të shpejtë** të sfidave;
3. **Përmirësim të vazhdueshëm** të veprimeve.

6.2 Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

6.3 Aktorët përgjegjës

- **Koordinatori për barazinë gjinore** do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.
- **Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (KBGJ)** do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

6.4 Treguesit e progresit

Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore në aktivitete, numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës, nivelit arsimor, punësimit, statusit martesor dhe zonës (urbane/rurale).

6.5 Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.
- **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

6.6 Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Në vitin e parë të zbatimit, Bashkia do të krijojë një Regjistër Dixhital për Monitorimin e Barazisë Gjinore, i cili do të përfshijë mbledhjen sistematike të të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë dhe indikatorëve të progresit të Planit Vendor 2026–2028. Kjo nismë do të zbatojë praktikat më të mira për publikimin e të dhënave në mënyrë transparente dhe të kuptueshme.

7. Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.